



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Datë /a/e:	18.02.2020
Referencë:	07-353/04-10054/20
Për / Za/ To:	Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë se Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	
Kontrolli:	Udhëheqësi i Sektorit: Habib Qorri
Punoi:	Punoi zyrtari :Sabri Gashi
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmes QSHQ, ka pranuar kërkesën e Bashkësish Islame të Kosovës, për shfrytëzimin e hapësirës publike vendosjen e Tendës për servisim të Iftareve gjate muajit te Ramazanit ne platon e Pallatit te Rinise.

Qëllimi i kërkesës është dhënia e ushqimit falas për qytetar gjate muajit te Ramazanit nga fondacioni „Ejup Sulltan” nga Stambolli .

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, nën shkronja g), i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, nr.01-110-157481, i jep

Pëlqimin

Bashkësia Islame e Kosovës ka kërkuar shfrytëzimin e hapësirës publike në Platon e Pallatit te Rinise por për arsye të kryerjes së punimeve te Pallati Rinisë në plato duhet të dislokoheni në sheshin „Adem Jashari” .

Shfrytëzimi i hapësirës ka të bëjë me organizimin e dhënies së Iftarit falas për qytetar nga fondacioni „Ejup Sulltan” nga Stambolli i cili organizon çdo vite në disa qytete në Kosoves .

Organizimi i aktivitetit lejohet të mbahet nga 24.Prill deri me 24.Maj .2019 ne sheshin „Adem Jashari “

Për vendosjen e objektit duhet të jen ekiye profesionale, nuk guxon të dëmtohen pllakat, vendoset me konstruksion dhe është me dim gjerësi 48.00x18.00 m , montimi munde të filloj (5)pese dite para fillimit te muajit te Ramazanit dhe të largohet ne afate deri ne tri (3) dite te përfundimit të Ramazanit .

Organizatori obligohet që:

- të mos paraqesin pengesë për lëvizjen e lirë të qytetareve;
- organizatori duhet te përmbush kriteret e dhënies së ushqimit ,të ketë kushtet sanitaro-hixhenike nga organet kompetente dhe për çdo mungesë dokumentacione apo ankesa në ushqim, helmim etj përgjegjësia është e organizatorit .
- Të ketë një kontratë me një kompani të pastrimit pasi në çdo moment duhet te barten barten mbeturinat nga lokacioni i aktivitetit .
- pas përfundimit të afatit të dhënë nga Drejtoria Tenda me objektet ndihmese duhet të largohet dhe hapësira të kthehet në gjendje të mëparshme .

Po ashtu, nëse kërkohet ndonjë urgjencë nga Komuna, hapësira duhet të lirohet në afat kohor të cilin e kërkon Komuna.

Faqe 1 nga 1